



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.11.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshëm Emine Fazliu e cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Fejzullah Fejza (udhëheqës i ekipit) dhe nga Neslihane Mati, Albesa Tolaj dhe Arta Birinxhiku (anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	7
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	26
5 Qeverisja e mirë.....	27
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	31
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	34
Shtojca III: Letër Konfirmimi.....	44

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 03.10.2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Shëndetësisë.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë së Shëndetësisë për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale përveç çështjeve në vijim:

Te neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme - burimi i fondeve ministria nuk ka prezantuar vlerën prej 57,025,125€ nga granti i qeverisë;

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - pjesa e hyrjes së parasë së gatshme në llogari të thesarit buxheti fillestar (2,425,015€) dhe buxheti final (2,009,903€) për huamarrje nuk është dashur të prezantohet;

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - pjesa e hyrjes së parasë së gatshme në llogari të thesarit, buxheti final nga grantet e përcaktuara të donatorëve ishte mbivlerësuar për 409,940€; dhe

Te neni 20 - Raporti për avancet e paarsyetuara ishte nënvlerësuar për 502,486€. Kategorinë e avanceve të paarsyetuara nuk ishim në gjendja ta testojmë për faktin se për mostrat tonat të përzgjedhura menaxhmenti i ministrisë nuk ishte në gjendje të na ofron dokumentacionin e nevojshëm si: kërkesën e aprovuar për udhëtim zyrtar, ftesën, agjendën, kërkesën për zotim dhe urdhër obligimet për pagesë.


Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasurit kapitale dhe jo kapitale të shpalosura në PFV nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të saktë.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Kontrollet e brendshme përgjatë vitit nuk kanë operuar në mënyrë efektive. Dobësi janë vërejtur në disa sisteme të rëndësishme financiare si në të hyra vetjake, paga, menaxhimin me barna, menaxhimin e avanceve për udhëtime zyrtare, menaxhimin e projekteve, pasuri dhe detyrime.



Ministri duhet të kryej një rishikim të proceseve në të cilat kontrollet e brendshme nuk kanë funksionuar dhe duhet të forcoj kontrollet ku dështimet janë identifikuar (shih çështjet nga 7 deri në 23).

Përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak dhe viteve të mëhershme nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Ministri duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar që rekomandimet e vitit paraprak dhe viteve të mëhershme të adresohen në mënyrë aktive. (shih çështjen 24)

Aranzimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial janë të dobëta. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm nuk i mbështetë zhvillimet në këtë fushë.



Ministri duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e llogaridhënies dhe raportimit menaxherial. Po ashtu të siguroj se NJAB do të jetë më efektive për parandalimin e dobësive dukuri këto që po e përcjellin ministrinë. (shih çështjet nga 25 deri 27).

Përgjigjet e Ministrit të MSH

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin Ministrisë së Shëndetësisë. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë së Shëndetësisë se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat financiare vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

- Në neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme - te burimi i fondeve ministria nuk ka prezantuar vlerën prej 57,025,125€ nga granti i qeverisë;
- Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - pjesa e hyrjes së parasë së gatshme në llogari të thesarit buxheti fillestar (2,425,015€) dhe buxheti final (2,009,903€) për huamarrje ishin prezantuar gabimisht. Buxheti i prezantuar nga huamarrja ishte buxhet i planifikuar për shpenzim e jo buxhet i planifikuar për inkasim. Këto vlera nuk është deshtë të prezantohen nga MSh për shkak se huamarrja është e prezantuar nga Ministrisë e Financave në PFV-të e konsoliduara;
- Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - pjesa e hyrjes së parasë së gatshme në llogari të thesarit, buxheti final nga grantet e përcaktuara të donatorëve ishin prezantuar gabimisht.

Ishin prezantuar 501,340€ ndërsa do duhet të jenë 91,400€, kemi një mbivlerësim prej 409,940€;

- Te neni 20 - Raporti për avancet e paarsyetuara ishte prezantuar 19,801€ ndërsa sipas shënimeve të thesarit duhet të jenë 522,287€. Kemi një nëndeklarim për 502,486€. Këto avance të paarsyetuara ishin për udhëtime zyrtare. Këtë vlerë ne nuk ishim në gjendja ta testojmë për faktin se për mostrat tonat të përzgjedhura menaxhmenti i ministrisë nuk ishte në gjendje të na ofron dokumentacionin e nevojshëm si: kërkesën e aprovuar për udhëtim zyrtar, ftesën, agjendën, kërkesën për zotim dhe urdhër obligimet për pagesë.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është e pavarur nga Ministria dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se:

- Neni 19.3.1- Pasuria kapitale (me vlerë mbi 1,000€) nuk prezanton vlerën e sakta të pasurive. Auditimi ka nxjerrë në pah se në regjistrin kontabël të SIMFK nuk ishte regjistruar e gjithë pasuria e blerë nga MSh në vitin 2017. Vlera e pasurisë (investimeve në vijim) prej 3,323,368€ nuk ishte regjistruar. Për këtë vlerë të paregjistruar është nëndeklaruar pasuria e MSh për vitin 2017.
- Në PFV, neni 19.3.2 pasuritë jo kapitale, ishin prezantuar me vlerë 1,093,708€. Ne kemi konfirmuar se regjistri i pasurive nën 1,000€, nuk kishte llogaritur zhvlerësimin e akumuluar që si refleksion ka bërë që saldo përfundimtare e paraqitur në PFV të jetë e mbideklaruar pasi që nuk është aplikuar zhvlerësimi.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i MSh-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Shëndetësisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV –të e MSh-së në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalsjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga Ministria e Shëndetësisë (MSh) kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Draft planin dhe planin përfundimtar të prokurimit.

Përveç gabimeve të cilat kanë ndikuar në kualifikim të opinionit dhe theksimit të çështjes, PFV përmbajnë edhe gabimet si në vijim:

- Te neni 16 - Raporti i të arkëtueshmëve i prezantuar prej 471,400€ ishte mbivlerësuar për 40,265€, pasiqë vlera e prezantuar prej 40,265€ nga periodhat e mëhershme ishte arkëtuar gjatë vitit 2017;
- Te neni 18 - Raporti i detyrimeve kontingjente i prezantuar prej 1,265,804€, ishte i nënvlerësuar për 220,533€, për shkak se MSh nuk i kishte përfshirë të gjitha pretendimet e palëve ndaj ministrisë.

Të gjeturat më lartë, tregojnë që përgatitja e PFV-ve nga Ministria e Shëndetësisë është menaxhuar në mënyrë të dobët.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e pasaktë për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

- Rekomandimi 1** Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për opinion të kualifikuar me theksim të çështjes. Ministri duhet të siguroj se me rastin e përgatitjes së PVF do të prezantohet burimi i fondit nga granti i përgjithshëm i qeverisë si dhe të hyrat e buxhetuara nga donatorët të prezantohen me vlera të sakta.
- Rekomandimi 2** Ministri duhet të siguroj se avancat e paarsyetuar do të prezantohen drejt dhe saktë në PFV si dhe të ndërmer hapa të menjëhershëm për të siguruar të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe mbylljen e tyre (arsyeshmërinë e tyre) ashtu siç kërkohet me rregullat përkatëse.
- Rekomandimi 3** Ministri duhet të siguroj se huamarrja nuk do të prezantohet si buxhet i planifikuar për inkasim në PFV e MSh.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të siguroj se do të bëjë regjistrimin e të gjitha pasurive mbi 1,000€ në regjistra e pasurive si dhe për pasurit nën 1,000€ të bëjë zhvlerësimin.
- Rekomandimi 5** Ministri, po ashtu duhet të siguroj se detyrimet kontingjente dhe llogarit e arkëtueshme identifikohen saktë dhe të prezantohen si të tilla në PFV.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Për shkak të mos zbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e prokurimit vazhdon të mbetet fusha më shqetësuese, duke rezultuar në vlerë shumë të dobët të arritur për para si dhe në vonesat e pa arsyeshme në përfundim të projekteve/shërbimeve.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë jo shumë të përshtatshme dhe nuk janë subjekt i rishikimeve nga menaxhmenti, poashtu në këtë kontekst nuk ka një sistem adekuat dhe gjithëpërfshirës për llogaritë e arkëtueshme si derivat i të hyrave.

Poashtu kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të menjëhershëm për të parandaluar pa rregullsitë e shpenzimeve si dhe shpenzimet jo racionale.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: performanca buxhetore respektivisht ngecja në realizimin e shpenzimeve për projekte kapitale, subvencionet dhe transferet që ndërlidhen me programin për trajtim mjekësor jashtë institucioneve publike shëndetësore dhe edukimin e vazhdueshëm specialistik, rexhistrimi i stokut farmaceutik në sistem ende nuk është përmirësuar, administrimi i pasurisë jo financiare është mjaft dobët i menaxhuar, fusha e obligimeve të papaguara nuk është duke u adresuar si duhet, detyrimet kontingjente nuk janë të plota ngase ende ministria nuk ka një pasqyrë të plotë për pretendimet e palëve ndaj saj dhe nuk dihet me saktësi sa janë pretendimet e palëve ndaj ministrisë, administrimi i parasë së imët dhe avanceve për udhëtime zyrtare është një problem serioz dhe shqetësues që është duke e përcjellë MSh.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	55,949,060	62,425,514	57,567,776	49,774,144	31,698,423
Granti i Qeverisë -Buxheti	53,524,045	59,435,868	57,025,126	45,671,695	31,390,978
Të bartura nga viti paraprake	-	-	-	59,151	100
Të hyrat vetjake ²	-	-	-	529	10,149
Huamarrja	2,425,015	2,009,903	443,041	3,723,344	56,737
Donacionet e jashtme	-	979,743	99,609	319,425	240,459

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 6,476,454€ apo 11.5%. Në këtë rritje ka ndikuar, rritja e grantit të përgjithshëm në vlerë prej 5,911,823€, e bërë me vendimeve të Qeverisë, buxheti nga donacionet e jashtme 979,743€, dhe buxheti nga huamarrja ishte zvogëluar për shumën 415,112€, për shkak të mos realizimit të projekteve kapitale të parapara nga kredia.

Në vitin 2017, ministria ka shpenzuar mbi 92% të buxhetit final ose 57,567,776€. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	55,949,060	62,425,514	57,567,776	49,774,144	31,698,423
Pagat dhe Mëditjet	9,589,820	8,333,947	8,313,972	7,940,750	7,652,757
Mallrat dhe Shërbimet	27,760,887	32,880,401	29,506,459	24,661,109	9,145,047
Shërbimet komunale	230,548	215,318	183,802	183,845	195,858
Subvencionet dhe Transferet	7,013,805	14,413,805	14,350,049	9,841,960	9,714,570
Investimet Kapitale	11,354,000	6,582,043	5,213,494	7,146,480	4,990,191

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me atë fillestar ishte zvogëluar për 1,255,873€ apo në masën prej 13%, kjo ka ndodhur për arsye se nuk ishte realizuar plani i personelit për rekrutimet e parapara dhe lëvizjes së stafit nga MSh në ShSKUK;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 5,119,514€. Kjo rritje ishte bërë me vendim të Qeverisë për të mbuluar nevojat për furnizimet me barna nga Lista Esenciale;
- Edhe kategoria e shpenzimeve komunale është zvogëluar në masë të lehtë për 15,230€ apo 6% si pasojë e dinamikës më të ulët të shpenzimit karshi buxhetimit;
- Ndërsa rritje në buxhetin final karshi atij fillestar kishte kategoria subvencione dhe transfere e cila me buxhetin final ka pasur rritje për 106% apo 7,400,000€, si refleksion i përshtatjeve buxhetore e poashtu edhe nga ndikimi direkt i grantit nga Ministria e Financave. Kjo shumë suplementare e ndarë në buxhetin final ka ndikuar në uljen e borxheve të larta në programin për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore; dhe
- Buxheti final për investime kapitale me vendim të qeverisë është zvogëluar për 4,771,957€, si rezultat i mos realizimit të projekteve sipas planifikimeve.

Çështja 6 - Realizimi i buxhetit

E gjetura	Planifikimi buxhetit nuk ishte bërë bazuar në analiza të mirëfillta dhe reale. Kjo ka shkaktuar nevoja që gjatë vitit 2017 të bëhen shumë përshtatje buxhetore nëpër kategori ekonomike. Pavarësisht rritjes buxhetore që ishte bërë në kategorinë mallra dhe shërbime për furnizim me barna, ministria kishte arritur ta shpenzoj vetëm 89% të buxhetit të kësaj kategorie. Një ngece e theksuar në realizimin e buxhetit ishte edhe te investimet kapitale që edhe përkundër zvogëlimit të buxhetit final kundrejt atij fillestar vetëm 79% e buxhetit ishte shpenzuar.
Rreziku	Dështimi për të bërë një planifikim të mirëfilltë dhe real të buxhetit mund të rrezikoj arritjen e objektivave të përcaktuar të ministrisë.
Rekomandimi 6	Ministri të siguroj se me rastin e planifikimit të buxhetit të analizohen nevojat dhe kërkesat reale dhe të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të ekzekutimit të buxhetit dhe aty ku vërehen ngeçjet në realizim të ndërmerr masat adekuate për të përmirësuar performancën buxhetore.

3.2 Të hyrat

Sipas shënimeve të thesarit ministra kishte realizuar të hyra në vlerë 4,614,915€. Ministria e Shëndetësisë nuk kishte bërë planifikim për të hyra të cilat planifikon t'i realizoj përgjatë tre viteve të fundit. Edhe pse Ministria nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e të hyrave të realizuara, ajo do të duhej të kishte planifikuar realizimin e të hyrave i cili do të shërbente si pikë referuese për përcjelljen e dinamikës së realizimit të tyre. Të hyrat realizohen nga programe të ndryshme dhe lidhen me shërbimet të cilat ofrohen siç janë licencimi, shitja e shërbimeve, gjobat nga inspektorati farmaceutik dhe shëndetësor, etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	0	0	4,614,915	4,923,661	3,432,782

Çështja 7 - Mospërputhje në mes kërkesës dhe shtypjes së banderolave

E gjetura Të hyrat e realizuara në Agjencionin e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) nga banderolat për vitin 2017 në librin kryesor ishin në vlerë 290,989€.

Udhëzimi Administrativ nr. 12/2013 për Vendosjen e Banderolave në Produktet Medicinale që Importohen, Prodhohen dhe Qarkullojnë në Republikën e Kosovës përcakton se shtypja e banderolave duhet të bëhet pasi që të bëhet kërkesa për to nga palët.

AKPPM gjatë vitit 2017 kishte shtypur 29,335,497 banderola, prej këtyre 29,098,931 banderola ishin shitur sipas kërkesës, ndërsa diferenca prej 236,566 banderolave të shtypura më shumë se atyre të shitura ishte rezultat i gabimeve në shtypjen e tyre nga AKPPM-ja. Banderolat e shtypura më shumë janë kthyer nga operatorët dhe gjenden në depon e agjencionit në këtë rast koston e këtyre gabimeve e bartë agjencionit.

Rreziku Proceset e dobëta të kontrolleve gjatë shtypjes së banderollave rrisin rrezikun e mos harmonizimit mes banderolave të shtypura dhe të kërkuara si dhe rrisin kostot e agjencionit.

Rekomandimi 7 Ministri duhet të bëjë shtimin e kontrolleve në lidhje me harmonizimin mes kërkesës dhe shtypjes së banderollave në mënyrë që sasinë e shtypura të jetë në përputhje me sasinë e kërkuar për të minimizuar kostot shtesë të agjencionit.

Çështja 8 - Vonesa në shqyrtimin e aplikacioneve për licencë importi të produkteve dhe pajisjeve mjekësore nga AKPPM

- E gjetura** AKPPM gjatë shqyrtimit të aplikacioneve për licencë importi për produkte dhe pajisje mjekësore kishte aplikuar Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Neni 98 paragrafi 2 përcakton se “afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetëpesë (45) ditë nga fillimi i saj”.
- Për kundër afateve të përcaktuara si më lartë, në pesë raste AKPPM gjatë shqyrtimit të aplikacioneve për licencë importi të produkteve dhe pajisjeve mjekësore kishte tejkaluar afatin e paraparë nga 7-25 ditë.
- Rreziku** Mos respektimi i afateve sipas kriterëve të përcaktuara ligjore rrit rrezikun e favorizimit/difavorizimit ndaj operatorëve.
- Rekomandimi 8** Ministri duhet të siguroj se shqyrtimi i aplikacioneve për licencë importi për produkte dhe pajisje mjekësore të bëhet në pajtim me kriteret e përcaktuara ligjore.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Shpenzimet ishin 8,313,972€ apo shprehur në përqindje rreth 99.76% e buxhetit. Numri i lejuar i stafit me ligj të buxhetit ishte 1,158 ndërsa aktuali ishte 1,002. Rezultatet e testimit tonë kanë rezultuar me:

Çështja 9 - Pagesë e dyfishtë

- E gjetura** Në një rast ishte bërë mbi pagesë për 1,074€ për një mjek specialist. Kjo ka ndodhur nga mungesa e kontrolleve të duhura me rastin e pagesave retroaktive.
- Rreziku** Mungesa e kontrolleve adekuate rrit rrezikun e dëmtimit të buxhetit të ministrisë.
- Rekomandimi 9** Ministri të sigurojë kontrolle adekuate për të siguruar që bëhet verifikimi i pagesave para dhe pas procesimit të pagesave si dhe për vlerën e paguar më shumë të bëhet kthimi i mjeteve.

3.4 Menaxhimi i personelit

Ministria e Shëndetësisë ende nuk ka arritur të vendosë një sistem menaxhimi adekuat për personelin, për më tepër disa çështje janë duke u përcjell nga viti në vit.

Çështja 10 - Mbajtja e pozitave kyçe me ushtrues detyre

E gjetura Paragrafi 4 i nenit 30 të ligjit nr. 03/L-149 për shërbimin civil, përcakton se “Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre muaj”.

Në MSh vazhdojnë të mbahen gjithsejtë shtatë pozita me ushtrues detyre, të cilat kishin tejkaluar afatin e lejuar ligjor për mbajtjen e pozitës në këtë formë.

Rreziku Mbulimi i pozitave me ushtrues të detyrës në periudhë më të gjatë se tre muaj, mund të ndikojë në cilësinë e performancës operationale të entitetit, pasi që stafi në këto pozita mund të mos jenë të nivelit të duhur.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të marrë masa të menjëhershëm që për pozitat të cilat mbuloohen me ushtrues detyre të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme me pozita të rregullta në pajtim me kërkesat ligjore.

3.5 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalishte ishte 33,095,719€, ndërsa shpenzimi 29,690,261€. Pjesëmarrjen më të madhe në këto shpenzime e bëjnë furnizimi me barna me 91% apo 28,089,401€, gjersa pjesa tjetër i dedikohet shpenzimeve tjera operationale. Nga testimet e bëra kanë rezultuar çështjen si në vijim:

Çështja 11 - Furnizim me barna në mungesë të fletëdërgesës

E gjetura Në pagesën prej 238,440€ për furnizim me barna, kemi konfirmuar mungesën e fletëdërgesave dhe fletëpranimeve për dy lloje barnash në vlerë prej 11,879€. Ne nuk kemi marrë siguri nëse për këtë vlerë të paguar nga MSh-ja, janë kryer në të vërtetë këto furnizime.

Rreziku Mungesa e kontrolleve adekuate rrit rrezikun që për pagesat e bëra për furnizime të mos pranohet shërbimi (barnat).

Rekomandimi 11 Ministri duhet të shtoj kontrolle për të siguruar se për të gjitha pagesat e bëra do të bëhet konfirmimi i pranimi të barnave.

Çështja 12 - Tejkalmi i sasive të kontraktuara

E gjetura Për kontratat publike kornizë, neni 38 i LPP parasheh “Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijim prej tij duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%)”. Nëse urdhërblertet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë -/+ tridhjetë përqind (30%)), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

Në katër kontrata kornizë kemi identifikuar tejkalm të sasive indikative më shumë se sa 30%. Edhe pse ishin tejkaluara kontratat kornizë MSh nuk i kishte ndërprerë ato. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së menaxherëve të kontratave. Shprehur në vlera financiare tejkalmi i sasive indikative ishte 88,254€.

Rreziku Mungesa e mbikëqyrjes ka shkaktuar tejkalm të sasive të caktuara indikative përtej tavanit të lejuar, me që rast, ishte bërë certifikim joadekuat i pagesave të cilat rrisin rrezikun e implikime financiare shtesë për të ardhmen.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të siguroj se kontratat kornizë do të përcillen gjatë implementimit nga menaxherët e projekteve, dhe të siguroj se certifikimi i pagesave nuk do të bëhet mbi tavanin e përcaktuar për kontratat kornizë.

Çështja 13 - Lidhja e kontratave kornizë me operator të ndryshëm për artikujt të njëjtë

E gjetura Zyra e prokurimit në vitin 2016³ kishte lidhur dy kontrata, me dy operator ekonomik të ndryshëm për furnizim me barna. Në kuadër të këtyre dy kontratave ishin përfshirë tri lloje të barnave të njëjta⁴ me çmime të ndryshme. Ministria ishte furnizuar me barnat e njëjtë paralelisht nga të dy operatorët.

Rreziku Lidhja e kontratave për furnizim me barna të njëjta me operatorë të ndryshëm dhe me çmime të ndryshme krijon paqartësi me rastin e furnizimit dhe ekspozon rrezik për dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të siguroj se zyra e prokurimit nuk do kontraktoj barna të njëjtë me çmime të ndryshme për periudhën e njëjtë kohore. Për më tepër, ministri duhet të inicioj rishikimin e rasteve të përmendura më lartë për të parandaluar dëmtimin potencial të buxhetit.

³ Kontrata e parë ishte lidhur me 13.10.2016 dhe tjetra me 07.12.2016

⁴ Dextrose sol për inf. 5%, 500ml, Naterium Chloride sol për inf 0.9%, 500ml. dhe Ringer sol për inf 500ml.

Çështja 14 - Mos regjistrim i barnave të blera në Sistemin e Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF)

E gjetura Moduli i Sistemit të Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF) është njëri nga komponentat e Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH). Në të duhet të regjistrohen të gjitha transaksionet (hyrjet ,daljet dhe sasia në stok) e barnave të Listës Esenciale.

Ne kemi vërejtur se barnat e blera për Listën Esenciale (LE) në vlerë 1,431,071€, nuk ishin rexhistruar në softuerin SMSF.

Rreziku Mos regjistrimi i blerjes së barnave në SMSF e vështirëson përcjelljen e furnizimeve dhe menaxhimin e barnave të LE, duke rrit rrezikun që MSh të bëjë furnizime përdërisa ka sasi të mjaftueshme në stok ose e kundërta të shkaktohen vonesa në furnizim me barna kur nevojiten ato.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të shtoj kontrole rreth menaxhimit të SMSF-së për të siguruar se të gjitha furnizimet (qarkullimi) e bëra për barna do të regjistrohen dhe evidentohen në sistem.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 14,413,805€, ndërsa shpenzimi 14,350,049€. Ato kanë të bëjnë me Trajtimin Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP), subvencionimin e specializantëve-Aftësimi specialistik, dhe subvencionimin e shoqatave/profesionistëve shëndetësor për Edukim të Vazhdueshëm Mjekësor (EVM). Në këtë fushë janë identifikuar shumë mangësi si rezultat i kontroleve të dobëta.

Çështja 15 - Mos harmonizimi me Spitalet në të cilat kryhet shërbimi për TMJIPSH

E gjetura Udhëzimi Administrativ UA nr.03/2017 për TMJISHP⁵ obligon që divizioni për TMJISHP të mbajë komunikim të rregullt me institucionet ku trajtohen pacientët të cilët i subvencionon MSh dhe në baza 3 mujore të sigurojë informacion për statusin e trajtimit të tyre.

Në shtator 2017 ishte themeluar komisionin për procesin e barazimeve ku në këtë komision nuk kishte ndarje të duhur të detyrave, pasi që dy zyrtarë të tij ishin pjesë e bordit ekzekutiv për TMJISHP dhe një anëtar tjetër ishte edhe certifikues i këtij programi. Komision nuk ishte marr seriozisht me procesin e barazimeve sepse, prej 100 ofruesve të shërbimeve për trajtimet mjekësor vetëm në tri raste ishin bërë barazime. Për më tutje, nga këto barazime ka dal se 111,054€ kanë mbetur mjete të lira të cilat ministra duhet t'i ndërmerr hapat e duhur për t'i kthyer në buxhet.

⁵ TMJISHP - Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike

Rreziku Mungesa e informacioneve të sakta rrit rrezikun që shumat të cilat janë destinuar për TMJIPSH nuk janë shfrytëzuar konform qëllimeve, poashtu rrit rrezikun që shumat e dedikuara të qëndrojnë të bllokuara jashtë buxhetit të MSh-së. Më tutje, ndarja jo adekuate e detyrave rrit rrezikun e gabimeve financiare.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të sigurojë se barazimet aktuale me ofruesit e shërbimeve të finalizohen për të pasur një pasqyrë sa më të qartë të pozicionit të MSh karshi ofruesve të shërbimeve. Aty ku mbeten mjete të lira të kthehen në buxhetin e ministrisë.

Çështja 16 - Mos arsyetim i mjeteve për trajtimet mjekësore të subvencionuara

E gjetura Udhëzimi Administrativ 03/2016 për TMJISHP parasheh që pacientët përfitues të programit për TMJISHP me rastin e përfundimit të trajtimit të ofrojnë në ministri faturat e trajtimit. Poashtu UA përcakton që pacientët kompensohen në vlerë prej 70% të vlerës së profaturës.

Ne kemi konfirmuar se asnjë nga pacientët të cilët kishin kryer trajtime mjekësore në spitalet private brenda dhe jashtë Kosovës nuk kishin sjell faturat e trajtimit.

Në një rast ministria kishte paguar më shumë se 70% e vlerës së profaturës. Çmimi i profaturës i ofruar nga spitali për trajtim mjekësor kishte qenë 24,500€, ndërsa vlera për pagesë do të duhej të ishte 17,150€. Për këtë rast MSh kishte paguar 28,000€ (për 10,850€ më shumë se vlera e duhur).

Rreziku Mos sigurimi i mbulueshmërisë së subvencionimit të pacientëve të trajtuar si dhe pagesa në vlerë më të lartë se sa përcaktohet me udhëzim rrit rrezikun e keq shfrytëzimit dhe dëmtimit të parasë publike dhe, nuk ofron siguri që subvencioni është përdorur për qëllimin e paraparë.

Rekomandimi 16 Ministri duhet të sigurojë mekanizëm adekuat i cili siguron respektim të plotë të obligimeve të pacientëve ndaj vendimeve të ministrisë, si një masë adekuate e arsyetimit të shpenzimeve të krijuara. Më tutje, shumat e paguar mbi vlerën e lejuar të kërkohet të kthehen në buxhetin e ministrisë.

Çështja 17 - Subvencionimi i OJQ-ve përmes bashkëfinancimit

- E gjetura** Marrëveshjet e mirëkuptimit parashohin që pas kryerjes së projekteve të subvencionuara, në MSh të dorëzohet raporti lidhur me shpenzimet e mjeteve buxhetore si dhe raportin e punës së kryer.
- Nga 10 mostrat e testuar për subvencionimin e OJQ-ve, në tri prej tyre (3,000€, 2,000€ dhe 30,000€) OJQ-të nuk kishin respektuar marrëveshjet e arritura me MSh-në duke mos dorëzuar raportet e kompletuara
- Rreziku** Mos respektimi i marrëveshjeve të arritura dhe mos siguri i llogaridhënies së plotë në lidhje me shpenzimet e mbuluara nga subvencionet e dhëna për OJQ-të, rrezikon që subvencionet të mos shfrytëzohen sipas destinacionit të tyre.
- Rekomandimi 17** Ministri duhet të sigurojë mekanizëm për implementimin e plotë të marrëveshjeve të arritura për subvencionimin e OJQ-ve. Në rast të mos raportimit të plotë nga OJQ-të, në të ardhmen të rishikohen masat e ndëshkimit apo edhe të ndalimit të subvencionimit të tyre.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,582,043€, ndërsa shpenzimi 5,213,494€. Kryesisht këto kanë të bëjnë me financimin e projekteve të cilat i bënë MSh në SHSKUK dhe nivelin parësor të shëndetësisë – komuna.

Gjatë auditimit ne identifikuam dobësitë si në vijim.

Çështja 18 - Tejkalime të sasive të kontraktuar gjatë implementimit të kontratave

E gjetura Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për prokurimin publik pika 61.22 thekson se "Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit pas aprovimit nga ZKA".

Në pagesat e testuara në vlerë prej 2,788,513€ për projektin "Ndërtimi i Klinikës Emergjente" (8,106,238€ vlera e kontratës) dhe pagesat 141,144€ për projektin "Ndërtimi i Qendrës së Shëndetit Publik në Ferizaj" (448,149€ vlera e kontratës), kemi identifikuar tejkalime në 31 pozicione të kontraktuara. Vlera financiare e tejkaluar për të dyja projektet është 297,171€ (270,176€ tek ndërtimi i Emergjencës dhe 26,995€ tek ndërtimi i QSHP-Ferizaj). Edhe pse kishte ndryshime të sasive nga kontratat fillestare të cilat reflektojnë në çmimin total të kontratave, zyra e prokurimit për këto tejkalime nuk kishte ndryshuar kontratat ashtu siç parashihet me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ.

Rreziku Tejkalimi i pozicioneve mbi sasi të kontraktuara rrezikon që të mos realizohen pozicionet tjera brenda kontratës, më tutje kjo rrezikon që kontratat të mos përfundohen sipas planit dinamik por edhe duke krijuar kosto shtesë deri tek finalizimi i tyre.

Rekomandimi 18 Ministri të siguroj që janë vendosur kontrole adekuate të cilat konfirmojnë saktësinë dhe rregullsinë e implementimit të projekteve në mënyrë që çdo projekt të implementohet sipas kushteve të kontratës.

Çështja 19 - Pagesa e dyfishtë nga MSh ndaj operatorit për qendrën e dializës në Mitrovicë

E gjetura Për kontratën "Meremetimi, punimet zejtare të objektit të qendrës së hemodializës kronike - Spitalin Rajonal të Mitrovicës" në vlerë 153,964€, ishte bërë një mbi pagës prej 22,401€. Kjo ka ndodhur për shkak se punimet të cilat ishin kryer dhe paguar me situacionin e parë ishin faturuar dhe paguar edhe me situacionin e dytë.

Rreziku Në mungesë të kontrolleve të duhura ka ardhur deri te mbipagesat për situacion të njejtë, si dhe ndikon që ministria të paguaj më shumë se sa vlera e kontraktuar.

Rekomandimi 19 Ministri duhet të siguroj mbikëqyrje adekuate gjatë realizimit të projekteve, në mënyrë që pagesat të kryhen në përputhje me situacionet përkatëse. Në rastin e tillë të kërkohet që këto mjete të zbriten në pagesat e mëtutjeshme.

Çështja 20 - Adaptimi i hapësirës në kardiokirurgji për vendosjen e angiografit

E gjetura Ligjit i Prokurimi Publik neni 28 pika 10 parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit."

Me datë 21.04.2017 ministria kishte nënshkruar kontratë për "Adaptimi i hapësirave për angeograf në QKUK" me vlerë 214,961€. Gjatë implementimit të kontratës për shkak të mangësive të projektit ishin shfaqur punë të pa parashikuar të cilat nuk kishin pasur mundësi me u përmbushur me kontratë. Kjo situatë ka rezultuar deri te shkëputja e njëanshme e kontratës nga ana e ministrisë. Për këtë kontratë ministria kishte shpenzuar 48,130€.

Më tutje, në mungesë të adaptimit të hapësirës për vendosjen e angiografit, pajisje e paguar nga huamarrja me datë 28.12.2016 në vlerë 2,110,000€, mbetet ende jashtë Kosovës.

Rreziku Mangësia e projektit ka shkaktuar dështim në implementim e kontratës. Shkëputja e një anshme e kontratës nga MSh rrit rrezikun e humbjeve financiare si rezultat i mundësive për padi të operatorëve. Mos funksionalizimi i angiografit ka ndikim të drejtpërdrejtë tek pacientët⁶ të cilët presin për trajtim.

Rekomandimi 20 Ministri duhet që të adresoj këtë çështje me prioritet të lartë, në mënyrë që ky projekt të implementohet sa më shpejtë për të minimizuar rreziqet nga humbjet e mundshme financiare. Dhe se, në një kohë sa më të shpejtë të ju ofrohet mundësia e trajtimit të pacienteve me këtë aparat.

⁶ Në listat të pritjes për procedura diagnostike janë rreth 1,000 pacient.

Çështja 21 – Vonesa në realizimin e projekteve si pasojë e hartimit të dobët të specifikimeve teknike

E gjetura

Gjatë auditimi të procedurave të prokurimit kemi identifikuar se njësitë kërkuese të cilat kërkojnë financim nga MSh janë duke i hartuar specifikimet teknike të tyre në mënyrë jo adekuate respektivisht të përgjithësuara duke lënë mundësinë që operatorët të ofrojnë mallra/punë ose shërbime të cilat nuk ofrojnë vlerën e kërkuar për para. Për më tepër, as njësia e prokurimit nuk i rishikon këto specifikime nëse janë të duhura për punë/shërbime apo mallra.

Në dy projekte si pasojë e hartimit të mangët të specifikacioneve teknike nga njësitë kërkuese implementimi i projekteve është përcjellë me problematika të ndryshme;

- Vonesa një vjeçare në pranimin e Autoambulancës për bartjen e të porsalindurve nga institucionet tjera shëndetësore në QKUK me vlerë të kontraktuar 76,760€. Kjo kishte ndodhur pasiqë, nuk ishte bërë pranimi teknik si rezultat i specifikimeve teknike të dobëta; dhe
- Te projekti dislokimi i Klinikës Pediatrike, me aneks kontratë ishte bërë ndryshimi i dy pozicioneve të kontratës bazë në sasi, kapacitet shpërndarës dhe çmim. Kjo kishte ndodhur për arsye se totali i punëve shtesë të pa parashikuara nuk mund të mbuloheshin me 10% të kontratës.

Rreziku

Hartimi i specifikacioneve jo në përputhje nevojat reale rrezikon mbarëvajtjen dhe implementimin e projekteve, rrit rrezikun e kostove shtesë si dhe nuk siguron vlerën e kërkuar për para.

Rekomandimi 21 Ministri duhet të siguroj kontrole në përpilimin e specifikacioneve teknike , si dhe të sigurohet se është kryer një rishikim i tyre nga departamenti i prokurimit para inicimit të procedurave.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të cilat vërtetojnë ekzistencën e pasurive dhe sigurojnë të dhëna të sakta dhe të azhurnuara për pasuritë e organizatës. Vlera e pasurive mbi 1,000€ e prezantuar në PFV ishte 3,863,275€, ndërsa nën 1,000€ ishte 1,093,708€. Përveç çështjeve të potencuar tek kapitulli opiniononi i auditimit, nuk kemi ndonjë çështje tjetër për të raportuar.

3.9 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

MSh në PFV të vitit 2017 kishte prezantuar vlerën 19,801€. Çështjet që ndërlidhen me këtë fushë i kemi paraqitura te kapitulli Opinioni i auditimit.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 4,266,793€. Përderisa në PFV e vitit 2016 kishte deklaruar 2,501,286€, prej tyre gjatë vitit 2017 ishin paguar 1,994,990€.

Struktura e obligimeve të vitit 2017, sipas kategorive është, mallra dhe shërbime 437,345€, subvencionet dhe transferet 3,795,480€ dhe shpenzime kapitale 33,968€.

Çështja 22 - Vlerë e lartë e obligimeve të papaguara

E gjetura Pjesa më e madhe e obligimeve i takojnë kategorisë Subvencione dhe Transfere (3,795,480€). Këto obligime janë rezultat i aprovimit të kërkesave për trajtim mjekësor të pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore nga bordi ekzekutiv i këtij institucioni pa pasur buxhet të aprovuar.

Rreziku Shumat e raportuara të obligimeve të pa paguara janë shuma domethënëse për buxhetin e ministrisë dhe si të tilla, mund të ndikoj në balancat buxhetore për vitin e ardhshëm.

Rekomandimi 22 Ministri të siguroj se bordi ekzekutiv i TMJIShP të ketë kujdes me rastin e aprovimit të kërkesave për trajtim të pacientëve, duke pasur në konsideratë mundësit buxhetore të ministrisë. Po ashtu duhet t'i jap prioritet shlyerjes së obligimeve për shkak se ministria mund të paditet nga operatorët ekonomik me që rast kostot do të rriten edhe më shumë.

Çështja 23 - Pagesa sipas vendimit gjyqësor

E gjetura Në vitin 2017, pagesa të bëra nga thesar përmes nenit 39.2 dhe vendimeve gjyqësore ishin 475,636€. Kjo kishte ndodhur për shkak se ministria nuk i kishte paguar obligimet me kohë me që rast operatorët i kishin realizuar të drejtat e tyre përmes thesarit apo vendimeve gjyqësore.

Rreziku Vonesat në pagesat e obligimeve mund të ndikojnë në prishjen e ekuilibrit buxhetor dhe rritë rrezikun që projektet e planifikuara me projeksionet fillestare të mos realizohen fare.

Rekomandimi 23 Ministri duhet të sigurojë se të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të MSh-së kishte rezultuar me 26 rekomandime. MSh kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, shtatë rekomandime janë zbatuar, dy ishin në proces të zbatimit dhe 17 mbesin të pazbatuara.

Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur 15 rekomandime (11 të pa zbatuara dhe katër ishin në zbatim e sipër). Gjendje pothuajse e njëjtë e këtyre rekomandimeve është edhe në vitin 2017. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 24 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Për shkak të menaxhimit të dobët të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Edhe pse është hartuar plani i veprimit, ministria nuk kishte formuar ndonjë komision për të monitoruar zbatimin e tyre.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe kanë rezultuar në:

- Cilësi të dobët të raportimit i cili ndërlidhet me PFV;
- Menaxhim shumë të dobët të avanceve për udhëtime zyrtare;
- Menaxhim jo adekuat të resurseve njerëzore ;
- Administrim të dobët të shpenzimeve, vlerë të munguar për para, efikasitet të dobët në planifikim dhe realizim, kontrolle të pamjaftueshme me rastin çertifikimit të pagesave; dhe
- Administrim të dobët mbi asetet jofinanciare dhe obligimet e papaguara.

Rekomandimi 24 Ministri të siguroj që është zbatuar plani adekuat dhe konsekuent i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MSh-së veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga MSh është shumë i ulët ku si rezultat i mos zbatimit të tyre problemet po thuhet të njëjta po e përcjellin ministrinë vit pas viti. Komiteti i auditimit nuk ka qenë në nivelin e duhur për të adresuar gjetjet e auditimit tek menaxhmenti. Menaxhim i dobët në fushën e personelit ku me vendim të U.D. Sekretari i Përgjithshëm kishte transferuar zyrtarin e lartë ligjor në auditor të brendshëm jo në pajtim me rregulloren 06/2010 për transferimin e nëpunësve civil.

AKPPM-ja nuk është duke i respektuar kriteret dhe udhëzimet tek importi i produkteve të cilat nuk kanë paralele në Kosovë. Ky proces ishte përcjellë me shumë ankesa nga palët, dhe me këtë rast AKPPM-ja iu ishte drejtuar Avokaturës Shtetërore për të marrë opinion. Si shkallë e dytë për ankesa AKPPM-ja kishte bordin e ankesave në AKPPM të cilin Avokati Shtetëror ishte anëtar.

AKPPM-ja nuk kishte definuar aktet nënligjore të cilat do të rregullojnë procedurat e regjistrimit, formatin dhe dosjen e regjistrimit sipas klasës së pajisjeve medicinale si masë parandaluese ndaj rrezikimit të sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit të pacientëve. Kjo nuk është në pajtim me Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale 04/L-190.

Sistemin e Menaxhimit të Stokut Farmaceutik nuk është menaxhuar në mënyrën e duhur për të siguruar regjistrimin e plot të barnave në këtë sistem.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me Drejtorin e NJAB dhe tre anëtarë të stafit.

Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe rreziqet e tjera të entitetit të audituar në funksion të ofrimit të sigurisë së mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

NjAB kishte hartuar planin strategjik 2016-2018, poashtu edhe planin vjetor i cili ishte aprovuar nga Ministri dhe KA.

Për vitin 2017 ishin planifikuar 17 auditime të rregullta dhe një sipas kërkesës. Ishin realizuar 17 auditime, 14 auditime bazuar në plan, dhe tre ishin kryer me kërkesë të menaxhmentit. Poashtu, në fund të vitit NJAB kishte përgatitur edhe një raport për implementimin e rekomandimeve të dhëna. Gjatë testimit tonë identifikua çështjet si në vijim;

Çështja 25 - Mangësitë në menaxhimin e NJAB-së

E gjetura Përkundër se NJAB ka bërë një numër të konsiderueshëm të raporteve, nuk ishte fokusuar në kryerjen e auditimeve të sistemeve kyçe dhe me rrezik të lartë gjatë 2017, siç janë shpenzimet për barna të LE, avancet e paarsyetuara për udhëtime zyrtare dhe menaxhimi i tërësishëm i pasurisë. Për më tepër, auditimet e kryera nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme se japin kontribut në përmirësimin e kontrolleve të brendshme sepse janë audituar vetëm sistemet parciais. Dhe se, nuk i kishte ofruar menaxhmentit këshilla për t'i eliminuar gabimet që ndërliidhen me zërat e PFV.

Asnjë njësi e audituar nuk kishte përgatitur plan veprimi për implementimin e rekomandimeve dhe si rezultat rekomandimet e kësaj njësie nuk ishin zbatuar.

Poashtu Komiteti i Auditimit kishte mbajtur tre takim, ndërsa në tre muajt e fundit KA nuk ka qenë funksional sepse dy nga anëtarët ishin larguar.

Rreziku Mungesa e fokusit nga NjAB në fusha kyçe dhe me rrezik të lartë, sjell rrezikun që NjAB të mos ofroj siguri të mjaftueshme menaxhmentit për funksionimin e kontrolleve të brendshme. Po ashtu, mos adresimi i rekomandimeve të NjAB-së dhe trajtimi jo i duhur i tyre ndikon që problemet e njëjta të përsëriten. Në këtë ndikon edhe mos funksionimi i komitetit të auditimit i cili rrezikon ecurinë e duhur në përmirësimin e funksionimit të NJAB-së.

Rekomandimi 25 Ministri të sigurojë se NjAB është e fokusuar në auditimin e fushave kyçe në mënyrë që menaxhmentit t'i ofroj siguri të mjaftueshme. Po ashtu një bashkëpunim më i ngushtë dhe një komunikim më efektiv në mes kësaj njësie dhe menaxhmentit do të ndikoj në parandalimin/eliminimin e dobësive të shumta që po e përcjellin këtë ministri. Më tutje, ministri të siguroj funksionimin e plotë të komitetit të auditimit.

Çështja 26 - Transferimi i zyrtarit ligjor si auditori i brendshëm

E gjetura Rregullorja 06/2010 për transferimin e nëpunësve civil, neni 8 parasheh se “Nëpunësi civil mund të transferohet në mënyrë të përhershme në një vend tjetër punë për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale, gradë dhe hap të pagës brenda institucionit në shërbimin civil”.

U.D. Sekretari i Përgjithshëm me vendim për transfer të datës 09.11.2017 kishte transferuar zyrtarin ligjor në pozitën e auditorit të brendshëm jo në pajtim me rregulloren sepse grada dhe hapi i pagës⁷ nuk ishin të njëjta. Për më tepër zyrtari i transferuar deri në muajin nëntor 2017, ka ushtruar pozitën e U.D. Sekretarit i Përgjithshëm.

Rreziku Transferi i nëpunësve civil të cilët nuk janë me gradë dhe hap të pagës të njëjtë rrit rrezikun e dëmtimit të buxhetit.

Rekomandimi 26 Ministri duhet të siguroj se me rastin e transferimit të nëpunësve civil të ketë parasysh ekuivalencën e gradës dhe hapit të pagës.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për një planifikim të mirë, për mbikëqyre të aktiviteteve në baza të rregullta dhe për vendimmarrje efektive, menaxhmenti i MSh-së ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet e masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë ministrinë.

Menaxhmenti i ministrisë ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi konfirmuar se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe se nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

⁷ Pagën bazë si zyrtar ligjor e kishte 582.73€, ndërsa tani në pozitën e auditorit të brendshëm pagën bazë e ka 872€.

Çështja 27 - Dobësi në kontrollet menaxheriale, llogaridhënie dhe menaxhimin e rrezikut nga njësitë vartëse të MSh-së

E gjetura Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore (FSSH), në administrimin e barnave të listës esenciale (LE) nuk është duke ofruar siguri se transaksionet janë në pajtim me kushtet e kontratës si dhe me aspektet tjera të operimit. Për më tepër informatat nga Sistemi i Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF) nuk janë të plota për arsye se shumë furnizime nuk janë evidentuar në të. Në mungesë të të dhënave kredibile edhe çertifikimi i pagesave është bërë duke mos ofruar siguri për mundësinë e tejkalimit të sasive të kontraktuara të furnizimeve.

Vlerat e prezantuara në PFV nuk verifikohen paraprakisht për të siguruar saktësinë dhe plotësinë e tyre.

Në programin për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP), nuk ka pasur raportim të mirëfilltë sepse vendimet e bordit për trajtimin e pacientëve nuk ishin bazuar në mundësitë buxhetore. Si pasojë e mungesës së raportimit të mirëfilltë kemi rritje enorme të obligimeve.

Si rezultat i paramasave dhe parallogarive dhe mbikëqyrjes së dobët të projekteve përgjatë vitit 2017 kishte shumë ndryshime të projekteve nga kontratat bazë, dhe shumë nga projektet ishin zvarritur gjatë implementimit.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Poashtu kjo rrit rrezikun për shpenzime të parregullta si dhe mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 27 Ministri të siguroj një raportim menaxherial dhe një mbikëqyrje efektive për të siguruar shtimin e vlerës për para. Për tu arritur kjo, ministri duhet të siguroj përfshirjen e të gjitha akterëve kyç në kuadër të ministrisë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1. Theksimi i çështjes	Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për ti përcaktuar shkaqet për Theksimin e Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për ti adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe praktike për ti hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe për të siguruar vlerësimin e saktë të pasurive, stoqeve, detyrimeve dhe të arkëtueshmëve.		PFV-të janë korrigjuar në lidhje me gabimet në klasifikimin e shpenzimeve më pasuritë: mirëpo nuk janë marrë veprimet e duhura në lidhje me vlerësimin e saktë të pasurisë, , detyrimeve dhe të arkëtueshmëve.	
2.Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet në lidhje me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			I pa zbatuar
3.Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Ministria kishte përgatitur planin e veprimit për zbatim të rekomandimeve të ZKA, por mos adresimi i plotë i rekomandimeve ka rezultuar në vazhdimin e dobësive të njëjta.	

9. Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim i brendshëm për çështjet e identifikuar të prokurimit, në të cilat rregullat dhe udhëzuesit nuk janë aplikuar në mënyrë efektive. Bazuar në këtë rishikim, të ndërmerren masat e nevojshme që mundësojnë shmangien e mangësive të tilla në të ardhmen.			I pa zbatuar
10. Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri duhet të siguroj që të zbatohen me përpikëri politikatat dhe procedurat e kërkuara me rastin e udhëtimeve zyrtare, duke dëshmuar dhe arsyetuar saktë shpenzimet e ndodhura dhe duke mbyllur me kohë avancet.			I pa zbatuar
11. Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri dhe Kryeshefi ekzekutiv AKPPM-së duhet të sigurojnë që të gjitha pagesat dhe shpenzimet të realizohen në përputhje me planifikimet paraprake, dhe të regjistrohen konform planit të aprovuar kontabël.			I pa zbatuar
12. Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri dhe drejtori i IKSHP-së duhet të sigurojnë që të gjitha pozitat udhëheqëse të ushtrohen me orar të plotë dhe me kontrata të rregullta të punës. Kësaj duhet ti paraprijë konkursi publik i zhvilluar në pajtim me rregullat në fuqi.			I pa zbatuar
13. Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të inicojë një rishikim gjithëpërfshirës të stafit të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta për të përcaktuar saktë nevojat për staf në AKPPM, dhe të gjitha pozitat e nevojshme të plotësohen me staf të rregullt, përmes procesit të hapur të rekrutimit.			I pa zbatuar

14. Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Pagesat për borde dhe komisione për zyrtarët specifik janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi pasi që nuk lejohet pjesëmarrja në më shumë se një bord apo komision. Kjo mund të shkaktojë pagesa të parregullta dhe dëmtim eventual të buxhetit. Përveç kësaj angazhimi në borde/komisione gjatë orarit të punës rrit rrezikun që zyrtarët të mos i kryejnë obligimet e tyre ditore si rezultat i angazhimit në detyra tjera.	I zbatuar		
20. Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të siguroj që programet e subvencionuara të jenë subjekt i monitorimit të rregullt nga zyrtarët e Ministrisë, për të siguruar respektimin e kërkesave për raportimin e mënyrës së shfrytëzimit të mjeteve. Po ashtu, mos të vazhdojë subvencionimi i shoqatave profesionale për EVM përderisa nuk i arsyetojnë shpenzimet e mjeteve financiare të përfituara nga MSh.			I pa zbatuar
21. Të hyrat	Ministri duhet të sigurojë që të funksionalizohet moduli për të hyra në kuadër të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh), i cili do mbështeste mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave. Po ashtu, Kryeshefi i AKPPM-së duhet të sigurohet që regjistrat e brendshëm për të hyrat të jenë të sakta dhe të harmonizohen me SIMFK-në. Kjo do të mundësonte shpalosjen e informatave të sakta në PVF.			I pa zbatuar
22. Pasuritë dhe detyrimet	Ministri duhet të iniciojë një rishikim për të përcaktuar pse rregullat dhe procedurat e nevojshme për menaxhimin e pasurisë, nuk janë aplikuar dhe të përcaktojë masat e nevojshme për menaxhimin më mirë të tyre. Regjistrat e pasurisë duhet të azhurnohen në vazhdimësi për të siguruar shpalosjen e vlerës së tyre të saktë në PVF.		Ministri kishte marr masa për adresimin e këtij rekomandimi, ishte vendosur zyrtari i pranimit, ishte bërë regjistrimi i pasurisë fikse, por nuk mund të përcaktohet nëse regjistri është i plotë dhe i saktë.	

23. Menaxhimi i Barnave	Ministri duhet të kërkojë një rishikim të kualitetit të informatave rreth stokut farmaceutik dhe mënyrës së përdorimit të SMSF-së, për të përcaktuar masat e nevojshme për përmirësimin e menaxhimit të tij. Sigurimi i informatave të sakta të stokut farmaceutik mundëson menaxhim më të lehtë dhe eviton mundësinë e theksimit të çështjes ose modifikimit të opinionit për PVF.			I pa zbatuar
24. Trajtimi i të arkëtueshmëve	Ministri duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim gjithëpërfshirës sa i përket qasjes ndaj llogarive të arkëtueshme duke i identifikuar pengesat në përmirësimin e shkallës së mbledhjes së të hyrave. Duhet të mbahen evidenca të sakta në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe informatat nga këto evidenca të shpalosen në PVF.		Ministri ka marr masat përmes përmbaruesve privat për të realizuar të hyrat e pa realizuara, por në disa njësi nuk është adresuar në masë të plotë.	
25. Trajtimi i borxheve	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar shkaqet e vonesave dhe masat e nevojshme për adresimin e kësaj çështje. Vlerësimi i detyrimeve duhet të bëhet në baza të rregullta mujore, dhe pagesat të bëhen sipas limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare.			I pa zbatuar

3. Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Ministria ka përgatitur planin e veprimit për zbatim të rekomandimeve të ZKA, por mos adresimi i plotë i rekomandimeve ka rezultuar në vazhdimin e dobësive të njëjta.	
4. . Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Ministri duhet të sigurojë se është rishikuar procesi i plotësimit të pyetësit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave ku janë evidentuar mangësi. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e përgjigjeve të dhëna në pyetësor si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	I zbatuar		
5. Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të sigurojë një rishikim të veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm. Duhet të ndërmerren veprime shtesë për të siguruar zbatimin e plotë të rekomandimeve të NjAB-së.			I pa zbatuar
6. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri dhe Drejtorët e Njësive të MSh-së duhet të sigurojnë që shpenzimet të buxhetohen dhe realizohen konform kodeve ekonomike adekuatë të parapara me legjislacionin në fuqi, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre.	I zbatuar		
7. Të hyrat	Ministri duhet që të sigurojë respektimin e kërkesave ligjore në lidhje me procesin – menaxhimin e të hyrave duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që njësitë vartëse të bëjnë regjistrimin e të hyrave në SIMFK. Po ashtu duhet të vihet në diskutim çështja e funksionalizimit të modulit të të hyrave në kuadër të SISh-it. Kjo do të mbështeste mbledhjen dhe menaxhimin e informatave rreth të hyrave.			I pa zbatuar

8. Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të sigurojë se do të rishikohet vendimi për kompensimin e kujdestarive, në mënyrë që ai të jetë, i bazuar dhe në përputhje me kërkesat e aplikueshme ligjore.	I zbatuar		
9. Pagat dhe mëditjet	Ministri së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të ShSKUK-së duhet të shqyrtojnë mundësinë që kompensimi për pagat e mjekëve specialist të bëhet nga buxheti i ShSKUK e jo nga Ministria.	I zbatuar		
10. Pagat dhe mëditjet	Ministri të sigurojë se çdo i punësuar që përfiton pagë në kuadër të MSH-së, të ketë dokumentim valid që vërteton mardhënien e punës dhe dosjen e kompletuar siç parashihet me kornizën ligjore.	I zbatuar		
11. Pagat dhe mëditjet	Ministri dhe drejtori i IKShP-së duhet të sigurojnë që të gjitha pozitat udhëheqëse të ushtrohen me orar të plotë dhe me kontrata të rregullta të punës. Kësaj duhet t'i paraprijë konkursi publik i zhvilluar në pajtim me rregullat në fuqi.			I pa zbatuar
12. Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të iniciojë një rishikim gjithëpërfshirës të rasteve në të cilat stafi është angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta për të përcaktuar saktë nevojat për staf me qëllim që të gjitha pozitat e nevojshme të plotësohen me staf të rregullt, përmes procesit të hapur të rekrutimit.			I pa zbatuar
13. Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të siguroj që planifikimi i numrit të stafit të bëhet në pajtim me nevojat reale dhe numri i stafit të planifikuar me buxhet të mos tejkalohet.			I pa zbatuar
14. Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të iniciojë zhvillimin e një politike të re rreth funksionimit të bordeve dhe komisioneve duke specifikuar në mënyrë të qartë udhëzimet rreth angazhimit, punës dhe kompensimit të anëtarëve të bordeve dhe komisioneve të ndryshme.			I pa zbatuar

15. Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të siguroj se përkrahja financiare të bëhet sipas rregullave të thesarit dhe se ndaj shfrytëzuesve që nuk i arsyetojnë shpenzimet janë marr masat për humbjen e të drejtës për aplikim të serishëm. Poashtu duhet të kërkohet nga ShSKUK që të gjithë personave të cilët nuk e kanë arsyetuar shpenzimin e mjeteve konform rregullave, t'iu zbatohen ndalesa në paga për vlerën e mjeteve që nuk janë arsyetuar.			I pa zbatuar
16. Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim i procesit, për të përcaktuar shkaqet e vonesave në adresimin e kërkesave për furnizim me barna, dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për menaxhim më të mirë të procesit të furnizimit me barna dhe material nga lista esenciale			I pa zbatuar
17. Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë që kërkesat e udhëzimeve administrative përkatëse të respektohen gjatë procesit të aplikimit dhe shqyrtimit aplikacioneve për TMJIShP, me qëllim që të përfitojnë personat meritore dhe në kohën e duhur për të arritur qëllimin e trajtimit.			I pa zbatuar
18. Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurohet se subvencionet paguhen duke u mbështetur në marrëveshje formale në mes të MSh-së dhe përfituesit, ku qartësohen obligimet e të dy palëve. Të bëhen barazimet financiare me institucionet private shëndetësore nëse ekzistojnë mjete financiare të pashfrytëzuara, dhe nëse po mjetet e tilla të ri-destinohen.		Subvencionet janë paguar sipas marrëveshjes mirëpo nuk po bëhen barazime.	

19. Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë që të ndërpritet mbështetja financiare e specializanteve të cilët janë identifikuar se punojnë edhe në institucione tjera dhe të shqyrtohen mundësitë ligjore për të kërkuar kthimin e mjeteve të përfituara në kundërshtim me kontratat. Po ashtu, në bashkëpunim me ATK dhe Trust-in, të merren masat e nevojshme për të verifikuar në baza mujore nëse specialistët që subvencionohen nga MSh realizojnë të ardhura edhe nga institucione tjera.	I zbatuar		
20. Subvencionet dhe transferet	Sa i përket punësimit të specialistëve, duhet të sigurohet që përparësi t' u jepet specialistëve të cilët nuk janë fare të punësuar, derisa specialistët që punojnë edhe në institucione tjera publike duhet të përcaktojnë pagat primare dhe sekondare në pajtim me kërkesat ligjore. Po ashtu, për specialistët të cilët janë identifikuar se punojnë në shërbimet primare shëndetësore, duhet të konsiderohet ndërprerja e marrëveshjeve.	I zbatuar		
21. Investimet Kapitale	Ministri duhet të sigurojë që mjetet e dedikuara për projekte të caktuara të buxhetohen dhe shpenzohen në harmoni me strategjinë e projektit dhe aktivitetet e parapara në planin e veprimit, në mënyrë që të përmbushen objektivat dhe qëllimi i projektit.			I pa zbatuar
22. Investimet Kapitale	Ministri dhe Drejtori i QKKTGj të sigurojnë mekanizma në forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit përfshirë këtu rritje të efikasitetit në planifikimin e aktiviteteve të prokurimit në raport me nevojat dhe buxhetin e disponueshëm. Po ashtu të sigurohet që çdo kontratë e dhënë publike të raportohet në harmoni me kërkesat dhe procedurat e parapara ligjore.			I pa zbatuar

23.Çështjet e përbashkëta për mallra dhe shërbime si dhe investime kapitale	Ministri dhe Drejtorët e Njësive të MSh-së duhet të sigurojnë respektimin konsistent dhe efektiv të rregullave/procedurave të prokurimit, dhe menaxhimin adekuat të kontratave për të siguruar arritjen e vlerës për parane e shpenzuar në prokurim. Një monitorim sistematik i realizimit të kontratave do të shtonte sigurinë tek menaxhmenti se kontratat po realizohen konform kushteve të kontraktuara.			I pa zbatuar
24.Pasuritë Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri dhe Drejtori i IKShP-së të sigurohen që të gjitha pasuritë e institucionit të regjistrohen në klasat e duhura të pasurive konform rregullores dhe legjislacionit në fuqi në mënyrë që vlera e tyre të prezantohet drejtë në PFV.			I pa zbatuar
25.Pasuritë Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri dhe Drejtorët e njësive duhet të sigurohen që menaxhimi i pasurisë jo financiare të organizatës të bëhet konform udhëzimeve ligjore si dhe të merren masa në drejtim të trajnimit të stafit dhe funksionalizimit të sistemit e-pasuria aty ku nuk aplikohet. Regjistrat e pasurisë duhet të jenë të plota, të përmbajnë të gjitha elementet siç përcaktohet me udhëzuesin përkatës si dhe të azhurnohen në vazhdimësi me qëllim të paraqitjes së gjendjes reale të pasurisë në pasqyra financiare.			I pa zbatuar
26.Të arkëtueshmet	Ministri duhet t'i analizojë arsyet e trendit të rritjes së këtyre llogarive dhe mos raportimit të saktë të tyre dhe t'i forcojë kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtutjeshme. Duhet të vendosen mekanizma adekuat dhe të shfrytëzohen të gjitha mjetet në dispozicion dhe veprimet ligjore për të mundësuar arkëtimin e borxheve të akumuluar.			I pa zbatuar

Shtojca III: Letër Konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
22.06.2018			
03	47	1124	2



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS / QKRA / GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIE E SHËNDETËSISË / MINISTRIJA ZDRAVSTVA / MINISTRY OF HEALTH	
Nr. i Origj. / Orig. No. / No. Original: 02 Nr. i Kopjeve / Copied No. / No. Copies: -5A-	Nr. i Proje / Proj. No. / No. Project: 05-4004 Data / Datum / Date: 22.06.2018
Fjalë / Words: Përfundim	

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
 Zyra e Ministrit / Ured Ministra / Office of the Minister

DATA:	22.06.2018
PËR/ZA/TO:	znj. Emine Fazliu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm z. Florim Beqiri, Udhëheqës i Departamentit të Auditimit / Zyra Kombëtare e Auditimit
CC:	z. Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë
NGA/OD/FROM:	z. Naim Bardiqi, UD Sekretar i Përgjithshëm / Ministria e Shëndetësisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Draft raporti i auditimit dhe Letra e Konfirmimit

Të nderuar,

Bashkëngjitur mund të gjeni draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit si dhe Letrën e Konfirmimit të Ministrit të Shëndetësisë, z. Uran Ismaili.

Me respekt,



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Uran Ismaili
Ministër



Prishtinë, 22.06.2018